



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2733/1 prot.

Tiranë më 31.10.2025

Lënda: Mendim mbi një marrëveshje ripranimi

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”) ka administruar shkresën tuaj me nr.4328/10 prot., datë 23.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2733 prot., datë 24.10.2025, me anë të të cilës dërgoni për mendim “*Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Pakistanit mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar*” së bashku me relacionin shpjegues.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të sipërcituar, konstatohet se në nenin 16 të marrëveshjes janë përcaktuar rregullat në lidhje me përpunimin dhe trajtimin e të dhënave personale, duke ia nënshtruar ligjeve të brendshme të palëve kontraktuese, si dhe parimet kryesore të përpunimit të të dhënave nga autoritetet kompetente të palëve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 40 të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “*Ligji*”) dhe Vendimit nr.1, datë 30.04.2025 të Komisionerit “*Për përcaktimin e shteteve që sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*” Republika Islamike e Pakistanit konsiderohet shtet me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, pasi nuk bën pjesë në listën e Aneksit nr.1.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se procesi i shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve ndërmjet palëve, legjitimohet duke plotësuar njërën nga masat e përcaktuara në nenin 41 të Ligjit.

Për sa më sipër, duke qenë se projekt marrëveshja parashikon nënshkrimin e një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve palë si dhe në të janë referuar rregullat dhe parimet bazë mbi mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit e vlerëson

projekt marrëveshjen të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi